



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:139816

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876179

KPPP.nr.1495/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Konica” SH.P.K., me NUI:810835762, me seli në Drenas, Parku i Biznesit, kundër debitorit “Arberia” SH.P.K., me NUI:810505729, me seli në Prishtinë, Zona Industriale, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.925/21 të datës 28.10.2021, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “Arberia” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.925/21, të datës 28.10.2021, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.925/21 të datës 28.10.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.0101 të datës 07.01.2021, Faturës Nr.0206 të datës 20.02.2021, Faturës Nr.0209 të datës 02.03.2021, Faturës Nr.0306 të datës 12.03.2021, Faturës Nr.0310 të datës 13.03.2021, Faturës Nr.0508 të datës 30.04.2021, Faturës Nr.0314 të datës 30.04.2021, Faturës Nr.0608 të datës 11.06.2021, Faturës Nr.0609 të datës 12.06.2021, Faturës Nr.0702 të datës 05.07.2021, Faturës Nr.0803 të datës 11.08.2021, Faturës Nr.0812 të datës 25.08.2021, Faturës Nr.0815 të datës 27.08.2021, Faturës Nr.0817 të datës 31.08.2021, Faturës Nr.0903 të datës 08.09.2021, Faturës Nr.0907 të datës 24.09.2021, dhe Faturës Nr.0907 të datës 30.09.2021, duke urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit shumën prej 25,560.01 €, me kamat ligjore 8%, nën kërcënim

të përbarimit të dhunshëm. Në të kundërtën përbarimi të realizohet përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të cilat debitori i posedon në të gjitha bankat komerciale, regjistrimit, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në realizimin e kërkesës së kreditorit si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se fatura të cilat janë objekt i procedurës përbarimore janë të paguara ashtu që nga vlera 25,560.01 €, janë të paguara 20,987.40 €, ndërsa dy faturat e kthimit të cilat janë mall i kthyer janë në shume prej 7,045.02 €, ku nga kjo del se kreditori i ka borxh debitorit dhe atë shumen prej 1,396.59 €. Tutje ka shtuar se sipas kartelës financiare të bashkëngjitur shihet qartë se debitori nuk ka obligim ndaj kreditorit, ndërsa kreditori ka obligime ndaj debitorit.

Kreditori në përgjigje në prapësim, e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke theksuar se qëllimi i vetëm i debitorit është shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. Tutje ka shtuar se faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përbarimore janë në origjinal janë të nënshkruara nga debitori si pranues i mallit, po ashtu në lidhje me këtë borxh kreditori ka lidhur marrëveshje me debitorin për pagesën e borxhit me këste por i njëjti nuk i është përmbajte marrëveshjes andaj kreditori ka vazhduar me procedurën përbarimore. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përbarimor P.nr.925/21 të datës 28.10.2021, të lejuar nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, e ka pranuar me datë 11.11.2021, e cila vërtetohet nga fletëkthesa e datës 12.11.2021 që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datë 14.06.2022.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përbarimore përcaktohet se: “Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimin të vendimit përbarues ose urdhrit përbarues”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja

ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.925/21 të datës 28.10.2021, e ka pranuar me datë 11.11.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 12.11.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 18.11.2021.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 14.06.2022, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të përmbaruesit privat Nr.925/21 të datës 14.06.2022, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me rreth 7 muaj vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1495/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.